

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kledian Llaho, me arsyetimin, sa vijon:

i) Lidhur me kriterin e pasurisë

1. Për sa i përket situatës së konfliktit të interesit

1.1. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka pasur në përdorim pa kundërshtim për një periudhë kohore një apartament me sip. 105 m², në Vlorë.

1.2. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.1.2017, shtetasi P. B., si përfaqësues me prokurë i shoqërisë “***” sh.p.k., deklaroi se pasurinë apartament banimi në Vlorë, ia jep në përdorim subjektit të rivlerësimit pa kundërshtim.

1.3. Marrëdhënia e subjektit lidhur me apartamentin në përdorim është një marrëdhënie juridike që ai e ka pasur me shoqërinë “***” sh.p.k., me administrator shtetasin F. K. Shtetasi P. B., referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 25.1.2016, ka qenë vetëm përfaqësuesi i posaçëm dhe ka pasur tagrin e dhënë për të kryer veprime juridike të caktuara, në emër e për llogari të shoqërisë “***” sh.p.k.

1.4. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur në shqyrtim dy çështje penale ku shtetasi F. K. ka qenë kallëzues duke u ndodhur në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 9367/2005, të interesit privat, për shkak të marrëdhënies së interesit pasuror të tij, gjatë ushtrimit të detyrës.

1.5. Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” që përkufizon konfliktin e interesit dhe rrethin e interesave private, dhe të nenit 17, pika 1, germa “ë” të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga këto çështje, për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

1.6. Lloji i vendimarrjes së subjektit të rivlerësimit, për çështjet penale, të referuara nga shtetasi F. K., nuk e përjashton subjektin e rivlerësimit nga detyrimi ligjor që ka pasur për heqjen dorë prej tyre.

1.7. Paanësia është esenciale për ushtrimin e detyrës. Prokurori duhet të japë dorëheqjen nga pjesëmarrja në një procedim në të cilin një vëzhguesi të arsyeshëm mund t’i duket se prokurori e ka të pamundur të vendosë me paanësi.

1.8. Rregullat e Etikës dhe Sjelljes së Prokurorëve, në nenin 3 “Parimet themelore”, germa “ë” përcaktojnë: *“Prokurorët, në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, duhet që: [...] ë) Të jenë dhe të tregohen objektivë, të pavarur, të paanshëm, të shmangin çdo papajtueshmëri me funksionin e tyre, të ndërjegjishëm për detyrimet etike e profesionale dhe të veprojnë në atë mënyrë që të nxisin besimin e publikut në dinjitetin, integritetin dhe ndershmërinë e tyre”.*

1.9. Në vlerësim të situatës së konfliktit subjekti ndodhet në situatën e kualifikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

2. Për sa i përket denoncimeve

2.1. Në Komision, është paraqitur një denoncim nga shtetasi H. M. i cili ka denoncuar se në kohën kur subjekti ka qenë me detyrë OPGJ në Sarandë, së bashku me vjehrrin e tij, ka ndërtuar objektin hotel ***-katësh në Sarandë.

2.2. Në Komision është paraqitur edhe një denoncim nga shtetasi S. S., ku referohet se prokurori Kledian Llaho hotelin në Sarandë në emër të vjehrrit e ka të tij.

2.3. Subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar se kanë përfituar të ardhura nga prindërit e bashkëshortes, përdorur si burim për depozitën bankare në “Credins Bank”, për llogarinë në “ProCredit Bank”, dhe për blerjen e apartamentit me sip. 105 m².

2.4. Trupi gjykues, me rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime dhe dokumente mbi kohën e ndërtimit të këtij objekti dhe të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave që kishin shërbyer për ndërtimin e tij, për të përjashtuar çdo fakt dhe rrethanë që mund të ngrinte dyshime për pasurinë objekt denoncimi.

2.5. Referuar shpjegimeve dhe provave të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ai nuk arriti t'i provojë trupit gjykues ligjshmërinë e burimeve financiare të prindërve të bashkëshortes, Për ndërtimin e hotelit “****” objekt denoncimesh duke mos përjashtuar faktet dhe rrethanat që ngrinin dyshime për pasurinë objekt denoncimi.

ii) Lidhur me kriterin e figurës

3. Trupi gjykues i Komisionit, në kuader të informacionit të ardhur për kontrollin e kriterit të figurës me rezultatet e hetimit, i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me disa dosje penale.

3.1. Bazuar në nenin DH të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 39 të ligjit nr.84/2016, faktet e rezultuara nga hetimi administrativ, në kuadër edhe të shpjegimeve të subjektit provonin se informacionet në ngarkim të subjektit të rivlerësimit sipas kërkesave të gërmave “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016 ishin të bazuara në rrethana konkrete.

3.2. Në këndvështrimin e përgjithshëm, edhe nëse ky konkluzion nuk do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion lidhur me kontrollin e pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, informacionet e disponuara mbi këto dosje penale cënonin pastërtinë e figurës së subjektit dhe shkallën e besueshmërisë së tij në zbatim të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër arsyetuar, lidhur me kriterin e pasurisë, figurës dhe denoncimet dhe kam arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cënuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke votuar për shkarkimin e tij nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Xhensila PINE
Anëtare/kundër

ⁱ https://hotel-***-sarande.booked.net/